



European
Policy
Institute.
Skopje



NATIONAL
DEMOCRATIC
DEBATE



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

DEBATI NACIONAL PËR DEMOKRACI

ANKETË DEBATIVE PËR PROMOVIMIN
E TRANZICIONIT TË SUKSESSHËM
DEMOKRATIK NË MAQEDONI

22-23 Qershor, 2019

PËRMBAJTJA

PYETJE DHE PËRGJIGJE

3

Përse ekziston nevoja për një dialog të hapur dhe të gjërë me qytetarët në lidhje me tranzicionin e suksesshëm demokratik në Republikën e Maqedonisë së Veriut?.....	3
Cili është qëllimi i këtij dokumenti?.....	4
Informatat që janë të siguruara në këtë dokument a janë të balancuara dhe të paanshme?.....	4

DEMOKRACIA

5

Çka është demokracia?.....	5
Përse demokracia?.....	6
Demokracia formale përballë asaj substantive?.....	6
Maqedonia e Veriut dhe demokracia.....	7
Etapat.....	7
Pikat kryesore të demokracisë; arritjet përkundër sfidave.....	7
Rangimi i shtetit sipas demokracisë.....	8
Maqedonia –një shtet i kapur?.....	8
Tranzicioni demokratik post-autoritar?.....	8

TEMA NR. 1: DEMOKRACIA FORMALE /INSTITUCIONET DEMOKRATIKE


9

Historiku dhe gjendja aktuale.....	9
Reformat gjyqësore dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.....	10
Forcimi i funksioneve të pavarësisë, efektivitetit dhe mbikëqyrjes së Kuvendit.....	14

TEMA NR. 2: BARAZI PËR TË GJITHË

16

Historiku dhe gjendja aktuale e punëve.....	16
Forcimi i legjisllacionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi.....	17
Trajtimi i përjashtimit social.....	19
Të drejtat gjuhësore.....	22



PYETJE DHE PËRGJIGJE

Përse ekziston nevoja për një dialog të hapur dhe të gjërë me qytetarët në lidhje me tranzicionin e suksesshëm demokratik në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

Në periudhën e kaluar, sidomos para vitit 2016, Republika e Maqedonisë¹ përjetoj një përkeqësim dramatik të sundimit të demokracisë. Tendencat autoritare kapën shtetin dhe privatizuan institucionet politike. Klientelizmi partiak, korrupsioni i shfrenuar dhe joliberalizimi u bënë tema të ditës. Zgjedhja e qeverisë së re më 1 qershor të 2017 premtoi ndryshime demokratike. Në periudhën pas autoritare që vijoi, tre çështje kishin rëndësi thelbësore: 1) Rithemelimi dhe përforcimi i institucioneve themelore demokratike të shtetit, 2) Ballafaqimi me mungesat strukturore demokratike të vendit, si formale ashtu edhe përmbajtësore, të cilat u zvarritën që nga pavarësia e vitit 1991 dhe 3) Forcimi i barazisë qytetare dhe rritja e kohezionit social në vend.

Krahas ndryshimit formal demokratik, demokratizimi përmbajtësor është një proces që do të merr shumë kohë. Vendimmarrja elitiste ende dominon përderisa po zë fill një diskutim gjithëpërfshirës politik që kalon vijat partiake dhe etnike. Për më tepër, kryesisht mungojnë perceptimi dhe pjesmarrja e qytetarëve në proces. Pikëpamjet e tyre mbi vlerat thelbësore të demokracisë dhe zbatimi i tyre në jetën e përditshme politike vështirë se dëgjohen në diskursin publik.

Debati nacional demokratik mbyll hendekun e dialogut demokratik të fragmentuar dhe jo përfshirës, duke forcuar kulturën e debatit publik të informuar në shtet. Ai synon të rrisë përfshirjen e publikut të gjerë me aktorët kombëtarë në një debat demokratik kombëtar që do të hap dialogun mbarëkombëtar mbi mekanizmat e nevojshëm për një tranzicion demokratik efektiv në Maqedoninë e Veriut.

¹ Në përputhje me Marrëveshjen e Prespës, ky dokument përdor emrin Maqedonia e Veriut kur i referohet periudhës pas 12 shkurtit 2019. Kur i referohet ngjarjeve para ratifikimit të marrëveshjes së Prespës përdor termin Republika e Maqedonisë.

Cili është qëllimi i këtij dokumenti?

Ky dokument është përmbledhje e dy temave të diskutimit të ngjarjes debative. Kjo mundëson:

1. Informata mbi demokracinë dhe gjendjen e zhvillimit demokratik në vend;
2. Informata plotësuese për dy tema: institucionet demokratike dhe barazi për të gjithë;
3. Disa qasje të mundshme të politikave në lidhje me dy temat dhe paraqitjen e argumenteve “për” dhe “kundër” në lidhje me tranzicionin e suksesshëm demokratik në vend

Ka një morri temash që mund të diskutohen në këtë drejtim, por për shkak të kufizimeve kohore fokusi i debatit, e me atë edhe ky dokument, është mbi institucionet demokratike dhe barazinë si dy temat e mëdha që kanë të bëjnë me proceset e tranzicionit të suksesshëm demokratik. Pasi që dokumenti nuk prezanton të gjitha qasjet e mundshme të politikave dhe argumenteve për dhe kundër tyre, ai shërben si një bazë për stimulimin e këtyre diskutimeve. Jeni të mirëseardhur të diskutoni argumentet “për” dhe “kundër” të cilat janë të paraqitura në këtë dokument dhe gjithashtu të sillni argumentet e juaja për diskutim të mëtejshëm. Argumentet për rrugët alternative janë më se të mirëseardhura.

A janë të balancuara dhe të paanshme informatat që janë të siguruara në këtë dokument?

Në përgatitjen e këtij dokumenti, ishte shumë e rëndësishme që informatat e siguruara të jenë objektive, të balancuara dhe të paanshme. Kemi konsultuar ekspertë kryesorë me pikëpamje të ndryshme mbi temat e adresuara dhe kemi hartuar dokumentin me ndihmën e partnerëve tanë. Personat, recensuesit, që e kontrolluan dokumentin nga aspekti i baraspeshës dhe saktësisë dhe komentet e të cilëve janë përfshirë janë:



- >>> Dr. Malinka Ristevska Jordanova
- >>> Dr. Xhemali Saiti
- >>> Dr. Marija Risteska
- >>> Dr. Simonida Kacarska
- >>> Mr. Biljana Kotevska
- >>> Mr. Jovan Bliznakovski
- >>> Mr. Igor Jovanoski

DEMOKRACIA

Demokracia, si një ide dhe praktikë politike u paraqit në Greqinë e lashtë. Fjala demokraci vjen nga fjalët greke “demos”, që do të thotë njerëz dhe “kratos” që do të thotë fuqia e qeverisë; kështu që demokracia mund të mendohet si „fuqia e popullit”: një mënyrë e qeverisjes e cila mvaret nga vullneti i popullit.²

Çfarë është demokracia?

E përmbledhur në fjalët e famshme të Abraham Linkolnit, demokracia është qeveri “e popullit, nga populli dhe për popullin.” Me fjalë tjera, demokracia është një përmbledhje formale e rregullave, procedurave dhe institucioneve, por edhe një mënyrë jetese. Është gjendje e shoqërisë e karakterizuar me tendencë drejt barazisë.³

Ekzistojnë shumë modele të ndryshme të ndryshme të qeverisjes demokratike në botë ashtu që ndonjëherë është më e lehtë të kuptohet ideja e demokracisë në kuptim të asaj se çfarë ajo definitivisht nuk është. Demokracia, pra, nuk është autokraci apo diktaturë, ku një person sundon; dhe nuk është oligarki, ku sundon një segment i vogël i shoqërisë. Nëse kuptohet siç duhet, demokracia nuk duhet të jetë as “sundimi i shumicës”, nëse kjo do të thotë që interesat e pakicave janë injoruar plotësisht. Një demokraci, të paktën në teori, është qeveria në emër të të gjithë njerëzve, sipas “vullnetit” “të tyre”.⁴



² <https://www.coe.int/en/web/compass/democracy>

³ Mary Kaldor, Ivan Vejvoda. 2002. Democratisation in Central and Eastern Europe. (Демократизација во Централна и Источна Европа) Continuum, London.

⁴ <https://www.coe.int/en/web/compass/democracy>

Përse demokracia?

Ideja e demokracisë e nxjerr fuqinë e saj morale - dhe tërheqjen e masave - nga dy parime kryesore:

1. **Autonomi individuale:** Ideja se askush nuk duhet t'i nënshtrohet rregullave të cilat janë imponuar nga të tjerët. Njerëzit duhet të jenë të aftë të kontrollojnë jetën e tyre (brenda arsyes).
2. **Barazia:** Ideja se secili duhet të ketë mundësinë e njëjtë për të ndikuar mbi vendimet të cilat ndikojnë tek njerëzit në shoqëri.

Këto parime janë tërheqëse në mënyrë intuitive dhe ato ndihmojnë për të shpjeguar pse demokracia është aq e popullarizuar. Sigurisht që ne mendojmë se është e drejtë që ne të kemi sa më shumë mundësi sesa kushdo tjetër për të vendosur për rregullat e përbashkëta!

Problemet lindin kur shqyrtojmë se si mund të vihen në praktikë parimet, sepse kemi nevojë për një mekanizëm për të vendosur se si t'i adresojmë pikëpamjet e kundërta. Pasi që demokracia ofron një mekanizëm të thjeshtë, ajo tenton të jetë "sundimi i shumicës"; por sundimi i shumicës do të thotë se interesat e disa njerëzve nuk përfaqësohen asnjëherë. Një mënyrë më origjinale e përfaqësimit të interesave të të gjithëve është përdorimi i vendimarrjes me konsensus, ku qëllimi është gjetja e pikave të përbashkëta të interesit.⁵

Demokracia formale përballë asaj substantive?

Siç thekson studimi me influencë i Kaldor dhe Vejvoda mbi gjendjen e demokracive Lindore-Evropiane, ekziston një dallim midis demokracisë formale dhe asaj substanciale.


1. Demokracia formale është përmbledhje formale e rregullave, procedurave dhe institucioneve që sigurojnë vendosjen ligjore dhe politike për funksionimin normal të demokracisë. Këtu kemi çështje të tilla si sundimi i ligjit, ndarja e pushtetit, zgjedhje të lira dhe të drejta, liria e shprehjes etj.⁶
2. Demokracia substantive është gjendje e shoqërisë e karakterizuar nga tendenca e saj drejt barazisë. Ajo që është e rëndësishme këtu, krahas tjerave, është edhe karakteri i kushtetutave dhe perceptimi i të drejtave të njeriut, roli i partive politike si mjet për pjesëmarrje demokratike, politike, roli i medias, administratës, shoqërisë civile etj. Do të thotë, mundësitë për pjesëmarrje dhe ndikim të individëve në rrethanat në të cilat ata jetojnë.⁷

Në përgjithësi, e para është korniza formale-institucionale e demokracisë, ndërsa e fundit përkthimi i saj në jetën e përditshme të qytetarëve në një shoqëri të caktuar. Veçanërisht, demokracia formale dhe substantive merren si kategori tipike ideale, ndërkohë që në praktikë, ato ndërthuren.

⁵ Ibid.

⁶ Mary Kaldor and Ivan Vejvoda, *Democratisation in Central and Eastern Europe* (Continuum, London) 4.

⁷ Kaldor and Vejvoda, *Democratisation in Central and Eastern Europe*, 3.



Maqedonia e Veriut dhe demokracia

Etapat

Republika e Maqedonisë fitoi pavarësinë e saj në 1991. Kushtetuta e parë e saj shpalli shtetin liberal demokratik të bazuar në parimet e demokracisë dhe sundimit të së drejtës. Në 2001, Kushtetuta pësoi ndryshime pas konfliktit të shkurtër të armatosur etnik. Të drejtat e barabarta kolektive të bashkësive të ndryshme etnike u nënvizuan si një nga parimet kryesore politike të shtetit. Në 2019, pas referendimit konsultativ për marrëveshjen mbi emrin me Greqinë,⁸ ndryshimet kushtetuese ndryshuan emrin e shtetit në **Maqedonia e Veriut**.

Pikat kryesore të demokracisë; arritjet përkundër sfidave

Që nga pavarësia në vitin 1991, janë bërë një sërë arritjesh:

- Shteti ka bërë tranzicion nga një demokraci e mëparshme një-partiake, socialiste me një ekonomi të planifikuar drejt një demokracie liberale, pluraliste të bazuar në sundimin e së drejtës dhe parimeve të tregut të lirë.
- Liria e fjalës, shprehjes dhe e shtypit është institucionalizuar ndërsa qytetarët e Maqedonisë janë të lirë të zgjedhin midis mendimeve të ndryshme politike.
- Partitë e organizuara politike u bënë aktorë të mëdhenj politik përderisa zgjedhjet përfaqësonin testet për idetë e tyre konkurruese. Stabiliteti ekonomik (me disa përjashtime të mëdha, siç ishte konflikti i shkurtër i armatosur në 2001) gjithashtu është ruajtur. Krahas pengesave, partitë etnike maqedonase dhe shqiptare kanë bashkëpunuar brenda institucioneve gjatë viteve.

Po ashtu, ka pasur sfida, të tilla si:

- Ndarja e pushtetit nuk është zbatuar plotësisht asnjëherë me atë që të sigurojë pavarësinë dhe kontrollin dhe bilancin ndërmjet degëve legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore të qeverisë.
- Elitat politike kanë kontrolluar procesin e demokratizimit, ndërsa procesin e tranzicionit e kanë karakterizuar korrupsioni dhe klientelizmi partiak.
- Marrëdhëniet ndëretnike kanë ngelur të brishta përgjatë viteve ndërsa në përgjithësi, qytetarët kanë qenë të përjashtuar nga procedurat e vendimmarrjes.
- Suvereniteti i popullit, edhe pse ka qenë i garantuar me kushtetutë, ka ngelur formal më tepër se sa përmbajtësor.

Në tërësi, vitet e tranzicionit i ka karakterizuar lufta e pabarabartë për demokracinë. Do të thotë se demokracia formale dhe procedurale i ka paraprirë demokracisë substantive, gjegjësisht të barabartë.

⁸ Veçanërisht, pragu ligjor i 50% (rreth 900.000 qytetarë) të votuesve nuk u arrit, gjithashtu për shkak të bojkotit të referendimit të organizuar nga kundërshtuesit e marrëveshjes. Nga ata që votuan, më shumë se 600.000, shumica e përgjithshme (më shumë se 90%) ka qenë në favor të ndryshimit të emrit. Shih: <https://www.bbc.com/news/world-europe-45699749>

Rangimi i shtetit sipas demokracisë

Duke u bazuar në këtë, analizat e njohura të jashtme - Raporti vjetor i Freedom House për 2016 e ka klasifikuar sistemin politik të Maqedonisë si një «Qeveri në tranzicion ose regjim hibrid». Ajo mban këtë klasifikim akoma. Me pak fjalë, është një sistem qeverisës në të cilin, edhe pse ka zgjedhje, qytetarët janë të izoluar nga njohuritë mbi aktivitetet e atyre që ushtrojnë pushtetin e vërtetë për shkak të mungesës së lirive të qytetarëve. Kjo është ilustruar nga rezultati i demokracisë për shtetin, i Freedom House, i cili vazhdon të bjerë që nga 2011, duke arritur nivelin më të ulët në vitin 2017. Në 2018, rezultati është përmirësuar paksa.⁹ Për më shumë, Ju lutemi shihni tabelën mëposhtë.

Kombet në kategorinë e tranzicionit dhe rezultati i demokracisë: Republika e Maqedonisë¹⁰

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Qeverisja nacional-demokratike	4.00	4.00	4.00	4.25	4.25	4.25	4.25	4.75	5.00	4.75
Procesi zgjedhor	3.50	3.25	3.25	3.25	3.25	3.25	3.50	3.75	4.00	4.00
Shoqëria civile	3.25	3.25	3.25	3.25	3.25	3.25	3.50	3.25	3.25	3.25
Mediat e pavarura	4.25	4.25	4.50	4.75	4.75	5.00	5.00	5.25	5.25	5.00
Qeverisja demokratike vendore	3.75	3.75	3.75	3.75	3.75	3.75	3.75	4.00	4.00	4.00
Korniza gjyqësore dhe pavarësia	4.00	4.00	4.00	4.00	4.25	4.25	4.25	4.50	4.75	4.75
Korrupsioni	4.25	4.00	4.00	4.00	4.00	4.25	4.25	4.50	4.75	4.75
Rangimi i demokracisë	3.86	3.79	3.82	3.89	3.93	4.00	4.07	4.29	4.43	4.36

Maqedonia – një shtet i kapur?

Para 2018, në veçanti, standardet demokratike në vend, të cilat gjithashtu përbëjnë themelin për anëtarësim në BE, janë degraduar. Shumë faktorë relevantë, duke përfshirë edhe raportet e KE mbi përparimin e vendit drejt BE-së, kanë shënuar tendenca jo-liberale dhe “shtet të kapur”. Që do të thotë se, interesat private, kryesisht partiake, kanë ndikuar dukshëm (dmth. kanë privatizuar) punën e institucioneve shtetërore si qeverisë, administratës publike, organeve gjyqësore, agjencive rregullatore dhe mediave.¹¹ Si rezultat i kësaj është rritur polarizimi në vend. Trazirat civile dhe protestat e vazhdueshme kanë mbushur boshllëkun demokratik. Marrëdhëniet ndëretnike kanë qenë gjithashtu të tensionuara ndërsa ndarjet e thella politike brenda-etnike janë rritur. Antagonizmi partiak ka arritur nivele të papara dhe ka kontribuar në vrullin që ka çuar në ngjarjet e 27 prillit 2017, kur protestuesit kanë mësyre parlamentin duke plagosur një numër deputetësh nga opozita.

Tranzicioni demokratik pas atij autoritar?

Zgjedhja e qeverisë së re më 1 qershor të viti 2017 ka dhënë një mundësi të re. Qeveria ka shpallur qartë kthimin në rrugën drejt aderimit në BE. Tani, përderisa ishte e qartë se ishin të nevojshme reformat demokratike, sfida ishte të definohet dhe zbatohet qasja më e përshtatshme. Natyrisht, zgjedhja dhe ritmi i reformave do të reflektojnë llojin e shtetit dhe shoqërisë në të cilin dëshirojmë të jetojmë. Do të ndikojë gjithashtu në perspektivat tona të ardhshme të BE-së. Veçanërisht, ndryshimi në kontekstin politik është shënuar edhe në raportet e KE-së. Ata panë një angazhim më të madh kësaj here, mes disa palëve të interesuara, për të trajtuar sfidat politike dhe për të marrë përsipër përgjegjësi në mënyrë proaktive. Nga pikëpamja e tyre, në shumë sfera, korniza e duhur demokratike, formale/rregullatore është e vendosur. Sidoqoftë, boshllëku i konsiderueshëm midis legjislacionit dhe praktikës, që ka shkaqe të ndryshme, ende duhet të kapërcehet. Sferat e rëndësishme, siç janë gjyqësori, siguria ose mediat, kërkojnë reforma sistematike të bazuara në një proces përfshirës, transparent dhe ndërpartiak. Si qeveria ashtu edhe e gjithë shoqëria duhet të angazhohen në procesin e reformave.¹²

⁹ <https://freedomhouse.org/report/nations-transit/2018/macedonia>

¹⁰ Ibid.

¹¹ Komisioni Evropian, Raporti mbi Maqedoninë 2016 https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

¹² Raporti i grupit të ekspertëve të lartë i 2015 (raporti i Pribe's) i porositur nga Komisioni Evropian https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf



DEMOKRACIA FORMALE / INSTITUCIONET DEMOKRATIKE

Historiku dhe gjendja aktuale

Demokracia, siç e kemi cekur më lartë, është rregullimi formal i rregullave demokratike, procedurave dhe institucioneve por gjithashtu një gjendje e shoqërisë e karakterizuar me një tendencë drejt barazisë.¹³ Gjatë 30 viteve të fundit, qytetarët e Maqedonisë së Veriut kanë mësuar se rregullat formale nuk përkthehen domosdoshmërisht në një demokraci funksionale, pjesëmarrëse dhe të barabartë. Siç e dimë, anshmëria partiake, korrupsioni dhe joefikasiteti vazhdimisht kanë dëmtuar demokracinë institucionale në vend. Në sistemin trepalësh, si legjislatura ashtu edhe gjyqësia kanë qenë një pre e vazhdueshme e ekzekutivit nga i cili ka kulmuar fuqia politike. Legjislatura, më së shpeshti, ka shërbyer për të ndjekur verbërisht direktivat e qeverisë sesa për të siguruar iniciativa të pavarura të veta. Ndërsa gjyqësori ishte jo më pak problematik. Një pre e vazhdueshme e lojërave politike, si dhe e rrjeteve të brendshme klienteliste ajo kurrë nuk u ngrit në rolin e ofruesit të pavarur dhe të paanshëm të drejtësisë për të gjithë. Si rezultat, sistemi politik ka qenë i mangët; parimi i kontrollit dhe balancit nuk është zbatuar kurrë plotësisht për të siguruar ndarje të barabartë të pushtetit. Nëse shtojmë këtu edhe shërbimin civil joefikas, partiak dhe joprofesional, atëherë kompletohet piktura e zymtë e proceseve të qeverisjes demokratike në shtet.

Në vitin 2017, pas zgjedhjes së qeverisë së re, janë prezantuar plane urgjente të reformave me prioritet, i ashtuquajtur plan "3-6-9", i pasuar nga plani "18".¹⁴ Reformat e synuara, të përshkruara në planet, u iniciuan nga Programi për punë i Qeverisë 2017-2020, duke marrë parasysh Marrëveshjen Politike të Przhino-s dhe në përputhje me rekomandimet e përfaqësuesve të BE. Duke iu përgjigjur kritikave mbi strukturën e dobët formale dhe institucionale të vendit, të dyja planet adresuan mangësitë strukturore demokratike. Në mënyrë të veçantë, qëllimet e tyre synonin elementet më të dobëta në ndarjen trepalëshe të pushtetit në vend. Së pari, ndërtimi i një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efikas; së dyti, përtërirja dhe zhvillimi i një mjedisi demokratik duke forcuar pavarësinë dhe funksionin mbikëqyrës të Kuvendit mbi punën e Qeverisë dhe, së treti, departizimin dhe profesionalizimin e administratës. Brenda këtij konteksti janë propozuar një sërë ligjesh sistemore dhe në të vërtetë, është parë përparimi.

Në përputhje me atë që është përmendur më lartë, fushat kryesore të identifikuara për ndërhyrje janë:

1. Sundimi i së drejtës - reformat e gjyqësorit dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit; dhe
2. Pjesëmarrja politike - përforcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe funksionit mbikëqyrës të Kuvendit;

Të gjitha këto fusha prekin reformat që kanë për qëllim forcimin e kornizës formale institucionale të demokracisë në vend.

¹³ Kaldor & Vejvoda. 2002. Democratisation in Central and Eastern Europe. Continuum, London.

¹⁴ <https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/Narrative%20Plan%206-9%20EN.pdf> and <http://www.sep.gov.mk/data/file/Dokumenti/Plan.18.ENG.pdf>

Reformat gjyqësore dhe lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Reformat gjyqësore janë transformimi i plotë apo i pjesërishtë i sistemit dhe procedurave të gjykatave dhe/ose të prokurorisë. Ndër të tjera, përfshijnë përforcimin e pavarësisë së gjyqësorit me këshillat gjyqësore ose ndryshimet në procedurat e emërimit, përcaktimit të moshës së pensionimit për gjyqtarët ose zgjerimin e pavarësisë për ndjekjet penale etj. Pavarësia e gjyqësorit, shkurtimisht, është që gjykatat të mos u nënshtrohen ndikimeve të pahijshme nga degët e tjera të pushtetit ose nga interesa private ose partiake.¹⁵

Në rastin e Maqedonisë së Veriut, sistemi gjyqësor është vlerësuar nga njëra anë si efikas në trajtimin e numrit të rasteve të pranuar, por nga ana tjetër si i politizuar. Presionet politike mbi gjyqësorin u konfirmuan në skandalin e përgjimit të vitit 2015, i cili zbuloi korrupsion në përmasa të mëdha, të nivelit të lartë, shkelje masive të së drejtës për komunikim privat dhe mungesë të kontrollit mbi agjencitë e inteligjencës dhe atyre të sigurisë.¹⁶ Pas një ndërmjetësimi të gjatë politik të mbështetur nga BE dhe NATO, në shtator të vitit 2015 u krijua një Prokurori Speciale (PSP) me detyrën për të hetuar dhe ndjekur penalisht individët e implikuar nga zbulimi i përgjimeve, në vend të prokurorisë së rregullt publike, e cila konsiderohej si partiake. Raporti i vitit 2017 i Grupit të ekspertëve të lartë mbi çështjet sistemore të Sundimit të ligjit ende vë në dukje kontrollin dhe keqpërdorimin e sistemit gjyqësor nga një numër i vogël i gjyqtarëve në pozita të fuqishme për të shërbyer dhe promovuar interesat politike.¹⁷ Sipas raportit, këta gjyqtarë kanë vazhduar të ushtrojnë presion mbi kolegët e tyre më të rinj përmes kontrollit të tyre mbi sistemet e emërimit, vlerësimit, promovimit, disiplinës dhe shkarkimit duke e karakterizuar këtë situatë si kapje të gjyqësorit dhe prokurorisë nga pushteti ekzekutiv.¹⁸ Në një shënim më pozitiv, krahas sjelljeve të pahijshme të një pakice, raporti shënon se shumë nga gjykatësit bëjnë çmos për të administruar drejtësinë në mënyrë të ndershme dhe të drejtë. Në përgjithësi, pavarësisht nga nevoja për të reformuar çështje të caktuara procedurale, ekziston një konsensus i gjerë se gjyqësori në vend nuk është i rrënuar nga themelet ligjore, por nga praktikat dhe sjelljet.

Propozim strategjia për reformimin e sektorit gjyqësor (SRSGj) e vitit 2017 ka adresuar këto çështje duke propozuar objektivat kryesore për reforma. Në thelb, ajo ka dhënë udhëzime për përmirësimin e sistemit të gjyqësorit duke tejkalluar mangësitë ekzistuese të karakterit **normativ** dhe **institucional**, duke trajtuar problemin themelor të ndërhyrjes së pushtetit ekzekutiv dhe të partizimit të sektorit të drejtësisë.¹⁹ Mjetet juridike të propozuara ishin: 1) vendosja e kriterëve objektive dhe jopolitike për përzgjedhjen dhe avancimin e gjyqtarëve dhe vëzhguesve nga Këshilli gjyqësor dhe Këshilli i prokurorëve publik, 2) vendosja e kriterëve objektive dhe meritorë për shpalljen e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë dhe 3) përforcimi i Prokurorisë speciale dhe Prokurorisë publike dhe Këshillit të prokurorëve publikë.

15 Francis Neate, Holly Nielsen. 2007. *The World Rule of Law Movement and Russian Legal Reform* (Justitsinform, Moscow), 5.

16 Raporti i grupit të ekspertëve të lartë i 2015 (raporti i Pribe>s) i porositur nga Komisioni Evropian https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf

17 Raporti i grupit të ekspertëve të lartë i 2017 (raporti i Pribe>s) i porositur nga Komisioni Evropian https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

18 Ibid.

19 Strategjia për reformë të gjyqësorit, 2017, Ministria e drejtësisë, në: <http://pravda.gov.mk/toc1/94>

Sa i përket 1 dhe 2, pas miratimit të SRSGj, janë miratuar Ligji për ndryshimin e Ligjit për gjykatat dhe Ligji për Këshillin gjyqësor, me qëllim të përmirësimit të procesit të vlerësimit të gjyqtarëve dhe kërkesave për emërim të gjyqtarëve. Sa i përket 3, ato u pasuan nga miratimi i ndryshimeve në Ligjin për Këshillin e prokurorit publik (KPP). Për të forcuar luftën kundër korrupsionit politik të nivelit të lartë dhe për të akomoduar dhe integruar punën e Prokurorisë Speciale (PSP) është propozuar Ligji i ri për Prokurorinë publike (PP). Për të siguruar raporte anonime të korrupsionit dhe ndjekje penale më efektive në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, janë miratuar ligje të reja për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të denoncuesve si dhe janë miratuar ndryshimet në Kodin Penal duke rumbullakësuar kështu kornizën ligjore të propozuar të SRSGj. Lidhur me këtë është edhe miratimi i Ligjit të ri për parandalimin e korrupsionit dhe zgjedhjen e Komisionit të ri shtetëror për parandalim të korrupsionit (KShPK).



Vijojnë propozimet dhe argumentet kyçe “për” dhe “kundër”, për miratimin e kornizës së propozuar.

Sundimi i së drejtës dhe reformat në gjyqësor	Argumente “për”	Argumente “kundër”
Të sigurohen kritere objektive dhe jopolitike për zgjedhjen dhe promovimin e gjykatësve:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përforcon pavarësinë e gjyqësorit për shkak se roli i tij i tanishëm ka qenë shumë i politizuar 2. Fut kritere të përmirësuara për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe ato më të larta (trajnimi i detyrueshëm në akademinë e gjyqtarëve, shërbimi i vazhdueshëm gjyqësor, renditje pozitive etj.) dhe 3. Paraqet masa dhe procedura të sakta disiplinore për shkarkimin e gjyqtarëve nga funksioni gjyqësor. 4. Përmirëson objektivitetin dhe pozitën publike të gjyqësorit në vend. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ridefinimi i kriterëve për zgjedhje, përparim apo shkarkim sigurisht që do të kenë ndikim. Ndërsa, pa pastrimin e sistemit nga gjyqtarët e korruptuar, Ligji i ri do të legjitimojë përbërjen e re të gjyqtarëve që ka qenë lëndë e ndikimit të fuqishëm politik ndër vite.
Të sigurohen kritere objektive dhe meritore për vlerësim të punës së gjykatësve dhe prokurorëve publik	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përforcon kompetencën e gjyqësorit që ishte shumë i komprometuar në vitet e fundit 2. Do të fut kritere të matshme sasiore si numri, lloji i vendimeve dhe rastet e zgjidhura në raport me numrin e rasteve të zgjidhura mujore për të ndjekur punën e gjyqtarëve individualë 3. Do të prezantojë kritere cilësore të matshme për punën e gjyqtarëve, si respektimi i afateve ligjore për ndërmarrjen e veprimeve procedurale, miratimi dhe publikimi i vendimeve gjyqësore përmes numrit të aktgjyqësive të konfirmuara, ndryshuara dhe të shfuqizuara në raport me numrin e përgjithshëm të rasteve të zgjidhura 4. Do të përmirësojë efikasitetin e gjyqësorit dhe, kryesisht, rikthejë rolin mbikëqyrës të Këshillit gjyqësor 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publik janë organet kryesore përgjegjëse për vlerësim. Në vitet e kaluara kanë qenë vazhdimisht të keqpërdorur nga një numër i vogël i gjykatësve dhe prokurorëve të fuqishëm dhe politikisht të korruptuar. Kështu, krahas kriterëve më të rrepta për vlerësim, pa një rivendosje të plotë të përbërjes së këtyre dy organeve, ligjet përkatëse mund të ndalojnë pjesërisht, por jo edhe plotësisht të shfuqizojnë praktikën e tyre shkatërruese.
Të sigurohet pavarësia e PP, duke integruar PSP në kornizën normative dhe institucionale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të sigurojë procedura objektive për emërimin dhe shkarkimin e prokurorit publik të shtetit pa ndikim të paligjshëm politik 2. Rivendosje integritetit të PP-së duke zgjeruar kompetencat, krijimin, heqjen, organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë Publike 3. Do të përcaktojë marrëdhëniet e PP me Prokurorinë Speciale (PSP), duke siguruar kornizën institucionale për luftimin e krimit të organizuar dhe zgjerimin e fushëveprimit për hetimet e të dyja zyrave. 4. Ruan autonominë e PSP që është e rëndësishme për të pastruar skandalin me përgjimet e paligjshme 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimit të Ligjit të ri për Prokurorinë publike i mungon kornizë e qartë për pavarësinë financiare dhe strukturore të PSP-së dhe sigurisht që kjo mund të dëmtojë efikasitetin e saj në kornizën e propozuar. 2. Përveç kësaj, disa thonë se ligji do të legjitimozojë procedurat e njëanshme të PSP-së kundër opozitës që do të krijojë bazë për persekutim të mëtejshëm politik.
Të sigurohet mbrojtja dhe dëshmitë e burimeve të informacionit në procedurat e ndjeshme të korrupsionit me profil të lartë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Do të përmirësohet efikasiteti i procedurave hetimore dhe gjyqësive të ndërlidhura 2. Do të hapë hapësirë për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe denoncuesve, të rëndësishëm për procedim në krime të organizuara tejet të ndërlikuara dhe të nivelit të lartë si dhe rastet e korrupsionit 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dobësi ligjore dhe institucionale për të ekzekutuar programe të tilla në të kaluarën, siç është dalja në publik e informatave për dëshmitarët e mbrojtur, hedhin dyshime mbi aftësinë për t'u marrë me këto çështje; 2. Në këtë drejtim, që nga miratimi i ligjit për denoncuesit në 2016 nuk është bërë asnjë paraqitje nga ana e denoncuesve. Kjo flet për nivelin e ultë të vetëdijes publike për rolin e denoncuesve, mosbesimin publik dhe mungesën e vullnetit politik për zbatimin e ligjit.

Sundimi i së drejtës dhe lufta kundër korrupsionit	Argumente “për”	Argumente “kundër”
Krijim i një sistemi të reformuar kombëtar kundër korrupsionit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përforcon efikasitetin dhe pavarësinë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe kornizën ligjore dhe institucionale kundër korrupsionit për shkak se roli i tanishëm i Komisionit është i pjesërishëm. 2. Do të zgjeronte kompetencat e KShPK në shumë fusha kritike të prirura për korrupsion sistematik, përfshirë këtu edhe financimin e partive politike. 3. Rikthen besimin publik në punën e saj; procedurat e përmirësuara për përzgjedhjen dhe shkarkimin janë gjithashtu në favor të kësaj. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rastet e mundshme të nepotizmit dhe ndërhyrjes politike në zgjedhjen e anëtarëve të KShPK hedhin dyshime mbi reformën e sistemit kundër korrupsionit. 2. Ligji i ri për parandalim të korrupsionit shkakton implikime fiskale mbi gjendjen e buxhetit për zbatim të legjisllacionit kundër korrupsionit. Akoma, ekziston një mungesë e pavarësisë së qartë të KShPK. Veçanërisht, buxheti i saj duhet të miratohet çdo vit nga Kuvendi, me kërkesë të mëparshme nga komisioni. Kështu, ka vend për ndërhyrje politike që mund të vë në dyshim pavarësinë dhe efikasitetin e KShPK-së për vitet në vijim. 3. Sistemi kundër korrupsionit varet nga funksionimi i institucioneve të shumta, duke përfshirë Prokurorin publik dhe koordinimin e tyre, që do të thotë se një institucion nuk është garanci për sukses.



Forcimi i funksioneve të pavarësisë, efikasitetit dhe mbikëqyrjes së Kuvendit

Në demokracitë liberale, parlamentare, Kuvendi është institucioni qendror demokratik. Në përgjithësi, një kuvend modern ka tre funksione: përfaqësimin e elektoratit, ligjvënien dhe mbikëqyrjen e qeverisë përmes dëgjimeve dhe hetimeve. Në Maqedoninë e Veriut, funksionet e dobëta legislative dhe mbikëqyrëse të Kuvendit kanë qenë të vazhdueshme. Siç e bëri të njohur raporti i KE-së i vitit 2016, Kuvendi ka nevojë “të përmirësojë ndjeshëm punën e saj si një forum për dialog dhe përfaqësim konstruktiv politik. Theksi duhet të vihet në pjesëmarrjen aktive të të gjitha partive parlamentare, konsultim i duhur dhe vlerësim për ndikimin para miratimit të legjislacionit, mbikëqyrje e besueshme funksionale mbi punën e qeverisë dhe shërbimeve të inteligjencës, krijimin e përgjegjësisë politike për përgjimet e paligjshme dhe kapacitet për të monitoruar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në vend”.²⁰ Pas ndërhyrjes në Kuvend në vitin 2017, kur një turmë e zemëruar sulmoi dhe rrahu parlamentarët nga opozita, reforma e Kuvendit ishte e nevojshme më shumë se kurrë më parë. Jo vetëm që duhet të forcojë pavarësinë e saj në raport me Qeverinë, agjencitë për zbatim të ligjit dhe në veçanti me shërbimet e inteligjencës, të përmirësojë efikasitetin e tij në detyrat e përditshme demokratike dhe përfaqësuese, Kuvendi gjithashtu duhet sërish ta rizbuloj veten si një forum demokratik i qytetarëve që mbanë sovranitetin e tyre pa kompromis. Në 25 vitet e fundit, për fat të keq, rrallëherë ka ndodhur të jetë.

Prandaj, që të dyja planet, 3-6-9 dhe 18 adresuan çështjen e Kuvendit dhe shpallën një numër masash të ndërlidhura. Në thelb, forcimi i efektivitetit, llogaridhënies dhe pavarësisë, si dhe mundësia e funksionit mbikëqyrës të Kuvendit dhe trupave punuese parlamentare mbi punën e Qeverisë dhe të shërbimeve të saja të sigurisë dhe të inteligjencës ka qenë i një rëndësie primare. Për forcimin e efektivitetit të Kuvendit u miratua Kodi i ri i Sjelljes për deputetët e Kuvendit i pasuar nga kërkimi (ende vazhdon) për një marrëveshje të pranueshme politike për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, që është thelbësore për forcimin e efektivitetit dhe kapaciteteve të pavarura të Kuvendit. Veçanërisht, të dyja dokumentet janë të dizajnuara për të ndikuar dhe siguruar rregulla për të përcaktuar të gjitha vendimet dhe veprimet kryesore në Kuvend, dhe të gjitha aktivitetet që duhet zhvilluar brenda kufijve të përcaktuar prej tyre. Procedurat, nga ana tjetër, janë metodat specifike që zbatohen për të shprehur politikën në veprim në punën e përditshme të institucionit. Për të forcuar llogaridhënien e Qeverisë përballë Kuvendit, përveç atyre të rregullta, janë futur edhe seanca për pyetje tematike parlamentare, një herë në javë me kohëzgjatje prej një ore. Në drejtim të llogaridhënies demokratike të Kuvendit përballë sektorit civil, një instrument i ri, i quajtur “e-dritare”, është aktivizuar dhe është funksional, duke u mundësuar qytetarëve të aplikojnë për pjesëmarrje në seancat plenare. Për rritjen e zërit dhe pjesëmarrjen e bashkësive të marginalizuara në punën e Kuvendit, më 23 shkurt 2018, grupi parlamentar ndërpartiak për të drejtat e personave LGBTI²¹ u krijua për herë të parë në Kuvend.

²⁰ Komisioni Evropian, Raporti i Maqedonisë i vitit 2016, në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

²¹ LGBTI është shkurtesë për personat lesbike, gejt, biseksual, trans dhe interseksual.

Në vijim janë propozimet dhe argumentet kryesore për dhe kundër në lidhje me miratimin e kornizës së propozuar.

Kuvendi	Argumentet “për”	Argumentet “kundër”
Sigurimi i rolit mbikëqyrës të komisioneve parlamentare mbi punën e qeverisë	<ol style="list-style-type: none"> Fuqizon autoritetin e komisioneve - qartazi ka munguar në vitet e kaluara Forcon kriteret profesionale dhe ekspertizës së komisioneve për të shqyrtuar punën e qeverisë Do të rriste kompetencën dhe kapacitetin e komisioneve për të kontrolluar punën e qeverisë Forcon efikasitetin e përgjithshëm të Kuvendit, që nuk ishte rasti në vitet e kaluara 	<ol style="list-style-type: none"> Pos nëse integrohet në një kornizë më të fortë ligjore, e shoqëruar me një iniciativë të vendosur politike për një demokratizim të mirëfillt të Kuvendit, mekanizmat për mbikëqyrje dhe ngritje të kapaciteteve janë vetëm një zgjidhje e pjesërishme e problemit..
Sigurimi i mekanizmave efikas institucional të “pyetjeve parlamentare” - një formë kryesore për mbikëqyrje legjislative dhe shërbimit të qytetarëve	<ol style="list-style-type: none"> Ajo do të rriste numrin e temave dhe frekuencën e seancave në “pyetjet parlamentare” Do të përmirësonte aftësinë e Kuvendit për të pyetur rreth punës së Qeverisë Do të përmirësonte autonominë institucionale të Kuvendit përballë Qeverisë 	<ol style="list-style-type: none"> Vetëm një zgjidhje e pjesërishme e problemit. Varet gjithashtu nga mbështetja politike dhe bashkëpunimi dhe përgjegjësia e ministrive të ndryshme në ofrimin e përgjigjeve përkatëse (e që nuk ishte rasti më parë). Gjithashtu varet nga mbulimi i duhur nga mediat.
Mundësim që opozita të kryesojë me punën e një numri të konsiderueshëm të komisioneve	<ol style="list-style-type: none"> Do të forconte rolin mbikëqyrës të opozitës kundrejt shumicës në pushtet Do të nxiste nisma brenda-parlamentare për përmirësimin dhe promovimin e dialogut midis shumicës dhe opozitës Do të rriste besimin ndër-parlamentar dhe kohezionin ndaj Qeverisë 	<ol style="list-style-type: none"> Kontrolli më i fuqishëm nga opozita mund të çojë në blloki parlamentare, që ndodhte shpesh në vitet e mëparshme Akoma mungon një kornizë e qartë institucionale për bashkëpunimin brenda-parlamentar. Nevojiten masa dhe politika më të fuqishme për të kapërcyer hendekun e madh të mosbesimit ndërmjet deputetëve të pozitës dhe opozitës.
Mundësi për mbikëqyrje më të madhe dhe vendimtare të Kuvendit për punën e shërbimeve të sigurisë	<ol style="list-style-type: none"> Do të parandalonte keqpërdorimin politik të shërbimeve të sigurisë të cilat përbënin shkelje të rënda të të drejtave të njeriut gjatë viteve të fundit Do t'i jepte legjitimitet nismave për ngritjen e duhur të kapaciteteve të komisioneve parlamentare (siç janë punëtoritë dhe trajnimet, si dhe sfondin e duhur profesional në këtë fushë për deputetët që mbikëqyrin punën e shërbimeve të sigurisë) gjë që nuk ishte rasti në vitet e mëparshme Gjithashtu do të rriste përfshirjen dhe transparencën e procesit të mbikëqyrjes; ofronte hapësirë për sektorin e OJQ-ve në proces Do të ofronte mekanizma më të mira për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe rendit kushtetues të vendit. 	<ol style="list-style-type: none"> Kontrolli më të fuqishme normative dhe procedurale mbi punën e shërbimit të sigurisë mund të pengojnë efikasitetin e tyre Nismat e gjera për një ose dy punëtori të rastit për anëtarët e komisioneve nuk janë të mjaftueshme. Kornizë e qartë për ndërtim të vazhdueshëm të kapaciteteve (profesionale dhe eksperte) të nevojshme për mbikëqyrje efektive. Pjesërisht efektive nëse nuk sigurohet pjesëmarrje më e fuqishme e sektorit të pavarur të OJQ-ve/ekspertëve. Duke këmbëngulur në mbrojtjen e rreptë të të drejtave të njeriut dhe lirive liberale mund të rrezikojnë sigurinë kombëtare në çështje të ndjeshme siç janë parandalimi dhe luftimi i aktivitetëve të huaja
Rritja e nismave për pjesëmarrje qytetare në punën e Kuvendit	<ol style="list-style-type: none"> Rrit transparencën e Kuvendit Forcon nismat ekzistuese për pjesëmarrje qytetare në punën e Kuvendit, siç është “e-dritarja” Do të forcojë debatin për përfshirjen e bashkësive të marginalizuara në punën e Kuvendit (personat me aftësi të kufizuara, komuniteti LGBTI, etj) Rrit modalitetet për pjesëmarrjen politike dhe forcon përgjegjësinë demokratike të Kuvendit drejt qytetarëve. 	<ol style="list-style-type: none"> Pengon karakterin përfaqësues të Kuvendit duke përfshirë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë demokratike nga ana e qytetarëve dhe OSHC-ve në punën e tij Zvogëlon efektivitetin e Kuvendit duke ofruar hapësirë për iniciativa të shumta të qytetarëve, ofron hapësirë për politika populiste në vend të politikave racionale-funksionale Ofron hapësirë të pakontrollueshme të diskutit liberal të të drejtave të njeriut (siç është ai për të drejtat LGBTI), që është kundër vlerave tradicionale të shoqërisë Rrit praktikën e egalitarizmit kundër individualizmit liberal



BARAZI PËR TË GJITHË

Historiku dhe gjendja aktuale

Që nga pavarësia në vitin 1991, barazia ka qenë një parim kushtetues dhe të gjithë qytetarët e vendit tonë, sipas Kushtetutës, konsiderohen të jenë të barabartë përpara ligjeve. Megjithatë, në praktikë, vendi është përpjekur me vështirësi për të vendosur ekuilibrin e duhur në arritjen e barazisë për të gjithë qytetarët e saj. Për fillim, pas vitit 1991, periudha e tranzicionit goditi rëndë shumë familje, duke shkaktuar varfëri ekonomike. Përveç rrënimit të shtetit të mirëqenies dhe rritjes së pabarazisë sociale, barazia gjinore u përkeqësua, duke e bërë atë një objektiv të ngritjes së zërave konservatorë në shoqëri. Fundi i viteve 1980 dhe 1990 ishin gjithashtu vite kur vendi shkuroi të drejtat e bashkësive etnike jo-shumicë. E fundit, nga ana tjetër, çoi në trazira dhe përfundimisht në konflikt në vitin 2001 dhe në angazhimin e ripërtërirë për barazi në formën e ndryshimeve kushtetuese. Prandaj, parimi i barazisë, së bashku me atë të përfaqësimit të barabartë, u ngrit në nivelin e një vlere themelore të Kushtetutës.

Kohët e fundit, qeveria ka promovuar konceptin «Një shoqëri për të gjithë» dhe është angazhuar në një dialog publik për të gjetur mënyra për të nxitur barazinë në vend.²² Janë bërë disa përpjekje me miratimin e Ligjit të ri për Parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, paketën e propozuar të reformës sociale dhe Ligjin për Përdorimin e gjuhëve. Megjithatë, ngjarjet e mëvonshme tregojnë se ekziston një përcaktim i dyshimtë drejt një shtytjeje të vërtetë për barazi. Ka vazhdimësi në praktikën e punësimit partiak duke komprometuar parimin e përfaqësimit të barabartë. Përveç kësaj, reforma e ligjit kundër diskriminimit u përball me kundërshtimin e forcave konservatore, duke përfshirë kishat më të mëdha dhe bashkësitë fetare në vend. Ndjentat fetare u cituan si pengesa për avancimin e mbrojtjes kundër diskriminimit. Gjithçka e përmendur më lartë prek shumë më tepër gratë.

Në përputhje me të lartpërmendurat, fushat kryesore të identifikuar për ndërhyrje janë:

3. Forcimi i legjislacionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi;
4. Mbrojtje sociale më e gjërë dhe më efektive dhe ndihmë kundër varfërisë; dhe
5. Legjislacioni për të drejtat gjuhësore, duke përfunduar zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit.

Të gjitha këto fusha i prekin reformat të cilat janë mbështetur dhe kundërshtuar ashpër nga figurat publike. Megjithatë, debati ishte i bllokuar me informacione jo të plota si dhe nganjëherë edhe me të rreme. Në kohën kur thirrjet për bashkimin e një kombi të ndarë vijnë nga të gjitha anët, është e rëndësishme të jepet mendimi juaj në mënyrë që të jemi në gjendje të kuptojmë se ku qëndron opinioni publik për këto çështje.

²² Një projekt strategji për Një shoqëri dhe ndërkulturalizëm po diskutohet në të gjithë vendin në verën e vitit 2019. Në Strategjinë, Një shoqëri përfshin: njohjen e të gjitha dallimeve, garantimin dhe sigurimin e barazisë, drejtësinë sociale, mundësitë e barabarta, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe arritjen e kohezionit social.

Forcimi i legjislacionit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi

Parimi i barazisë, siç është theksuar më sipër, është miratuar me kushtetutë që nga pavarësia e vendit në vitin 1991. Ajo, që nga ajo kohë, është përkthyer në dispozita të veçanta legjislative në shumë ligje. Megjithatë, nuk kishte legjislacion të plotë për trajtimin e pabarazisë dhe diskriminimit. Shoqëria civile ka thirrur për një ligj për mbrojtje kundër diskriminimit që nga viti 2004, vite përpara se të bëhej një pikë referimi (benchmark) lidhur me procesin e pranimit në BE. Me Ligjin e Punës nga viti 2005, të gjitha bazat për diskriminimin e barazisë në BE, duke përfshirë edhe orientimin seksual, janë mbrojtur me ligj në sferën e punësimit. Megjithatë, deri në vitin 2008, asnjë qeveri nuk tregoi vullnet politik për të ecur punën për një propozim legjislativ që do të ishte ligj gjithëpërfshirës. Kjo ishte koha kur BE-ja e vendosi këtë legjislacion si një pikë referimi (benchmark) në procesin e liberalizimit të vizave Shengen.

Cili është saktësisht standardi i vendosur në legjislacionin e BE-së?

Në vitin 2000, pas rigjallërimit të racizmit, BE vendosi të përmirësojë mbrojtjen nga diskriminimi në bazë të racës dhe etnisë në fusha të ndryshme, përfshirë mbrojtjen sociale, arsimin dhe punësimin, dhe ngriti standardet minimale të mbrojtjes. Kjo u pasua nga një legjislacion i BE-së që përcakton standardet minimale për mbrojtjen nga diskriminimi në punësim me një varg arsyesh për diskriminim - feja, besimi, orientimi seksual, aftësitë e kufizuara ose mosha. Gjinia dhe barazia gjinore ishin tashmë të zhvilluara sipas ligjit dhe politikës së BE-së (që nga vitet 1970), duke mbrojtur gratë në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe duke i mbrojtur ato nga diskriminimi lidhur me shtatzëninë dhe lindjen. Të gjitha këto pjesë të legjislacionit së bashku shpesh quhen si "direktivat e BE-së për barazi".

Çfarë nënkuptojnë këto "standarde minimale" në ligjin e BE-së?

Të gjitha direktivat e BE-së për barazi vendosin vetëm standarde minimale për mbrojtje nga diskriminimi. Çdo vend mund të qëndrojë në këtë standard minimal ose të bëjë më shumë, por ky minimum duhet të miratohet dhe të ruhet. Kjo do të thotë se legjislacioni është në vend për të përmirësuar situatat ku dikush është trajtuar në mënyrë të paligjshme, në mënyrë të pabarabartë në një ose më shumë baza diskriminimi. Këtu janë disa shembuj se çfarë do të thotë kjo. Është e paligjshme nëse: nuk jeni thirrur për një intervistë pune vetëm për shkak se jeni turk; refuzohet ndihma mjekësore vetëm për shkak se jeni lezbike; ju jeni të privuar nga e drejta juaj për të votuar, sepse nuk mund t'i qaseni vendvotimit në karrocë invaliditeti, etj. Këto standarde gjithashtu kërkojnë garanci minimale procedurale dhe institucionale se ligji do të zbatohet në mënyrë efikase. Pra, për shembull, kërkon barrë më të lehtë në procedurë mbi personin që inicon një rast diskriminimi. Kërkohet që të caktohet ose të themelohet një organ i pavarur për t'u marrë me rastet e diskriminimit.

Ligji i parë për Parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi në vend u miratua në vitin 2010, i cili nuk ishte në përputhje me standardet minimale, nëpërmjet një procedure të shkurtuar parlamentare.

Për shembull, këtu janë përmendur disa nga mënyrat se si këto standarde minimale nuk janë respektuar:

1. Kuptimi i aftësisë së kufizuar lidhej vetëm me aftësinë e kufizuar mendore dhe fizike, duke lënë forma të tjera të aftësisë së kufizuar, si p.sh. paaftësia shqisore (për shembull, njerëzit me dëmtime në të pamurit e tyre) pa një mbrojtje të qartë nga ligji.
2. Orientimi seksual është nxjerrë nga versioni i adoptuar edhe pse është pjesë e standardeve minimale të BE-së.
3. Barra në procedurën e personit që ngre një rast diskriminimi ishte shumë e rëndë, më shumë se sa ajo që parashikohej me ligjin e BE-së.
4. Mënyra se si Komisioni për Mbrojtje nga diskriminimi (i njohur edhe si organi i barazisë) nuk është themeluar në një mënyrë që e bën këtë organ të pavarur dhe efikas.

Që nga viti 2010, Komisioni European po i bën thirrje vendit të sjellë ligjin në përputhje me standardet minimale të BE-së, siç janë organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile. Ky rekomandim ka qenë pjesë e çdo raporti vjetor. U përgatit një projektligj i cili korrigjoi të gjitha pikat e diskutueshme, duke përfshirë të gjitha nga shembulli i mësipërm.²³ Ligji i ri për Parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi u miratua në mars të vitit 2019. Pikat në vijim mund të veçohen si mundësi dhe sfida në lidhje me miratimin e ligjit.

Propozim	Argumentet "për"	Argumentet "kundër"
Për të zbatuar plotësisht legjislacionin e ri kundër diskriminimit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shtrirje personale e rritur: Më shumë njerëz mund të përfitojnë nga mbrojtja kundër diskriminimit. 2. Korniza e përmirësuar institucionale: Trupi i barazisë është riorganizuar dhe ka baza juridike më të forta për pavarësi. 3. Njohja e më shumë formave të diskriminimit: Diskriminimi ndodh në shumë forma. Ligji i ri njih më shumë diskriminime, se sa ligji i mëparshëm. 4. Potencial më i madh për të trajtuar diskriminimin sistemik: Ligji i jep shtetit më shumë mjete për të trajtuar në mënyrë sistematike diskriminimin. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mungesa e vullnetit politik: Procesi shumë i kontestuar i adoptimit duket se sugjeron se ka mungesë të vullnetit politik për të mbështetur zbatimin e këtij ligji. 2. Zmbrapsje kundër orientimit seksual dhe identitetit gjinor: Kishte rezistencë të konsiderueshme për përfshirjen e këtyre bazave në ligj, duke sugjeruar se çdo veprim i mëtejshëm në lidhje me këto mund të haste edhe në kundërshtim. 3. Sfidat e organit për barazi: Mungesa e vullnetit politik sinjalizon se duhet të priten disa çështje, të tilla si sigurimi i përbërjes së mirë të anëtarëve të komisioneve për t'u ulur në organin për barazi, ose duke i dhënë burime të mjaftueshme për ta mbështetur atë për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në masë të plotë të kompetencave të parapara me ligj. 4. Vendosja e një precedenti të rrezikshëm potencial që dëmton pavarësinë e institucionit kombëtar për të drejtat e njeriut: Ligji parashikon ndërprerjen e mandatit të përbërjes aktuale të Komisionit për Mbrojtje nga diskriminimi.

²³ Një propozim-ligj u dërgua në Parlament në qershor të vitit 2018 dhe ishte i bllokuar për 7 muajt e ardhshëm. Përveç kësaj, pamë rritje në kundërshtimin e forcave konservatore, duke përfshirë kishat më të mëdha dhe bashkësitë fetare në vend. Ndjenjat fetare u cituan si pengesa për avancimin e mbrojtjes kundër diskriminimit.

Trajtimi i përjashtimit social

Privatizimi dhe tranzicioni në vitet 1990 la shumë njerëz në rrezik varfërie ose në varfëri. Në 2017, 460,300 njerëz (një e katërta e popullsisë në vend) jetonin në varfëri.²⁴ Shkalla e papunësisë ishte 25.5%, ndërsa 26.4% e atyre që kishin një punë ishin vlerësuar të jetojnë në rrezik varfërie apo në përjashtim social.²⁵ Nga popullsia e përgjithshme, 41.1% jetojnë në rrezik varfërie ose përjashtim social (krahasuar me mesataren e BE-së që është 23.5%).²⁶ Mesatarisht, gratë fitojnë 12.5% më pak për punë me vlerë të barabartë. Përqindja e personave në të ashtuquajturin punësim të cenuar - që do të thotë persona që janë të punësuar në ekonominë gri, të vetëpunësuar ose të cilët kryejnë punë të papaguara (siç është kujdesi për një anëtar të familjes), është 21.8% (krahasuar me mesataren e BE-së e cila është 11.8%).²⁷ 26,160 familje marrin ndihmës sociale financiare.²⁸ Studimet konfirmojnë, gjithnjë, se masat e mbrojtjes sociale janë joefektive dhe se ato nuk adresojnë nevojat reale të marrësve.

Kriteret për fitimin e një pensioni gjithashtu po bëhen më të rrepta. Pasi që shumica e njerëzve që humbën vendin e punës gjatë tranzicionit tani po afrohen apo kanë hyrë në moshë pensionimi, kriteret më të rrepta do të thotë se shumë prej tyre mund të qëndrojnë jashtë mbulimit pensional. Situata e vështirë e sigurimeve sociale dhe varfëria godasin gjithashtu personat e moshuar dhe në disa aspekte i bëjnë ata të jenë pjesë e popullsisë veçanërisht e rrezikuar.

Qeveria e tanishme është themeluar mbi, ndër të tjera, premtimin për të bërë diçka për të adresuar këto çështje. Ashtu që, ka propozuar tre pako reformash:

1. Reforma e mbrojtjes sociale: Propozimi për një Ligj të ri për Mbrojtjen sociale duhet të sjellë ndryshime në qasjen ndaj mbrojtjes sociale në përgjithësi.
2. Reforma pensionale: Propozimi për një ligj të ri për sigurimin social të të moshuarve do të prezantojë për herë të parë një "pension social" të ashtuquajtur.

Të gjitha këto hapa sjellin mundësi dhe sfida.



24 http://www.stat.gov.mk/pdf/2018/4.1.18.94.pdf?fbclid=IwAR1Cbt8_fJw5l_5dwPHWhjEzN6cvl5_H3gthh_Ufr-ZMXXigTgtmcNeaYYQ

25 <http://tinyurl.com/y4ctrlkw>

26 <https://ec.europa.eu/eurostat/web/income-and-living-conditions/data/database?fbclid=IwAR15rZOEFUaFWgK6D7l615G1wmOK-3BlwqAqrT5Vgpq34Oel4FI3uzrqTw>


27 http://library.fes.de/pdf-files/bueros/sarajevo/14452.pdf?fbclid=IwAR14LgGzn1IZVd6CHRPa6fMNUDyJFh_dhXl1jUbhHFOzD7-VxoEltT290sl

28 <http://www.stat.gov.mk/OblastOpsto.aspx?id=3>

Propozim	Argumentet "për"	Argumentet "kundër"
<p>Të zbatojë plotësisht reformën e mbrojtjes sociale</p>	<ol style="list-style-type: none"> Zgjerimi i shërbimeve sociale: Reforma e propozuar do të zgjerojë shërbimet sociale të cilat ia ofron personave në nevojë sociale. Zgjerimi i mbulimit të mbrojtjes sociale: Numri i njerëzve që do të përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale rritet, ashtu si edhe kategoritë e marrësve. Qasje më e mirë ndaj varfërisë: Masat e ofruara dhe shumat e rritura të ndihmës sociale kanë një potencial më të madh për të ngritur njerëzit mbi vijën e varfërisë dhe për t'i mbajtur ata larg varfërisë. Potencial më i madh për t'iu qasur çështjeve të mbrojtjes sociale në mënyrë sistematike: Ligji do t'i japë shtetit më shumë mjete për identifikimin sistematik, menaxhimin dhe sigurimin e nevojave të mbrojtjes sociale të familjeve dhe individëve (si individë dhe si pjesë e familjeve). 	<ol style="list-style-type: none"> Rritja e shpenzimeve publike: Kjo reformë do të thotë që më shumë fonde duhet të sigurohen nga buxheti publik për nevoja sociale. Kjo do të thotë më pak fonde për shpenzime në gjëra të tjera. Ndikimi i dyshimtë në aktivizimin: Nuk është plotësisht e sigurt se çfarë lloj efektesh do të ketë ndihma më e lartë financiare në aktivizimin e personave dhe nëse kjo nuk do të inkurajojë varësinë nga ndihma sociale dhe ajo shtetërore. Ligji parasheh detyrime të cilat duhet të trajtohen dhe ta kthejnë mbrapsht këtë potencial. Megjithatë, kjo mbetet një mundësi.



Propozim	Argumentet "për"	Argumentet "kundër"
Të hyjë në fuqi pensioni social në vend	<p>1. Ofrimi i më shumë sigurie sociale për të moshuarit në nevojë: Pensionet do të ndihmojnë në shtimin e sigurimit social për njerëzit që kanë arritur moshën e pensionit, por nuk kanë të drejtë për ndonjë lloj tjetër të pensionit dhe që nuk kanë ndonjë burim tjetër të të ardhurave.</p> <p>2. Përmirësimi i efekteve sociale të tranzicionit dhe të privimeve: Kjo masë ka mundësi të ndihmojë disa njerëz, pensionet e të cilëve u humbën për shkak të viteve të tensionuara të 1990ve kur ata humbën punën e tyre gjatë tranzicionit dhe privimit ose punëdhënësi i tyre kishte ndërprerë pagesën e kontributeve të tyre. Kjo, në mënyrë efektive, la shumë njerëz në shtet pa mundësi për siguri sociale në moshë të shtyrë, pavarësisht se sa vite kishin punuar para se të humbnin punën e tyre ose para se firma e tyre të mos paguante më kontributet e tyre (një praktikë e zakonshme).</p>	<p>1. Shtrirja e kufizuar: Masa do të ketë një shtrirje të kufizuar në aspektin e numrave dhe kategorive sociale që do t'i mbulojë. Kjo është kështu sepse vetëm një person nga një familje mund të përdorë një pension të tillë dhe se pensioni duhet të jetë burimi i vetëm i të ardhurave, ai person duhet të ketë të paktën një ditë të paguar të kontributeve të pensioneve.</p> <p>2. Rritja e shpenzimeve publike: Kjo reformë do të thotë se do të nevojiten më shumë fonde nga buxheti publik për të mbuluar pensionin social, pasi që deri më tani nuk janë paguar kontributet për këtë qëllim.</p> <p>3. Zvogëlimi i potencialit për t'u marrë me varfërinë: Duke marrë parasysh se personi që do të marrë pensionin social duhet ta ketë atë pension si burimin e vetëm të të ardhurave dhe duke e konsideruar faktin se ai është caktuar në më pak se 100 euro, nuk mund të pritet që kjo masë t'i ngritë ose t'i mbajë njerëzit jashtë varfërisë.</p> <p>4. Ka potencial që të jetë diskriminues në mënyrë të tërthortë ndaj grave dhe sidomos atyre nga zonat rurale: Masa është përgatitur në një mënyrë që të mos mund të përdoret nga një person, bashkëshorti/ja i/e të cilit merr një pension/një lloj tjetër të ardhurave. Në zonat rurale gratë, edhe pse punojnë në bujqësi, rrallëherë regjistrohen si "punëtorë të pavarur bujqësorë" dhe kështu rrallë paguajnë përfitime sociale në emër të vet. Kur vjen moshja e daljes në pension, gratë do të mbeten pa të ardhura, pension dhe siguri financiare të tyre.</p>




Të drejtat gjuhësore

Me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit më 2001, vendi ndërmori një detyrim për të reformuar gjithashtu mënyrën se si të drejtat gjuhësore mbrohen dhe ushtrohen në nivel kombëtar. Janë miratuar një sërë ligjesh dhe mekanizmash, asnjëra prej të cilave nuk arriti të rregullojë plotësisht pozitën e gjuhës së dytë amtare më të folur në vend - gjuhën shqipe. Një ligj i vitit 2008 mbi përdorimin e gjuhëve jo-shumicë u përpoq ta bënte këtë, megjithatë nuk arriti një përparim. Në vitin 2018, Qeveria propozoi dhe Kuvendi miratoi Ligjin për Përdorimin e gjuhëve, i cili siguron një bazë ligjore më të shëndoshë për pozicionin dhe përdorimin e gjuhës shqipe. Ligji gjithashtu siguron garanci më të forta ligjore se do të zbatohet siç duhet, duke përfshirë edhe sanksionet.

Megjithatë, miratimi i ligjit ishte i njollosur nga dy gjëra. Fillimisht, ligji u miratua në një proces shumë të kontestuar. Pas një vetoje nga Presidenti dhe votimit të dytë nga Parlamenti, Presidenti përsëri refuzoi të nënshkruante ligjin. Së dyti, ligji u ndesh me kundërshtime të ashpra midis një pjese të publikut, por edhe filologëve. Të fundit kishin një çështje me faktin se garancitë ligjore të paraqitura në këtë ligj ishin shumë më të forta sesa ato për përdorimin e gjuhës maqedonase

Propozim	Argumentet "për"	Argumentet "kundër"
Për të zbatuar plotësisht legjislationin e ri për gjuhët	<p>1. Rritja e qasjes ndaj shërbimeve publike: Ligji do t'u mundësojë një pjese të popullsisë të përdor gjuhën e tyre amtare në komunikim me shërbimet publike. Për shembull, ata do të jenë në gjendje të pyesin në gjuhën e tyre amtare përse nuk ka ujë në rrugën e tyre, ose për të paraqitur kërkesë për një certifikatë të re të lindjes.</p> <p>2. Rritja e besnikërisë së bashkësive gjuhësore ndaj (institucioneve) të shtetit: Mundësia për të komunikuar me shtetin në gjuhën amtare mund të ketë një efekt pozitiv në rritjen e besnikërisë ndaj shtetit.</p> <p>3. Angazhimi i Qeverisë për tejkalimin e distancës etnike: Ky ligj tregon përkushtimin e shtetit drejt tejkalimit të distancës etnike.</p>	<p>1. Proces i kontestuar i miratimit: Ligji u miratua në një proces që, sipas disave, kishte ligjshmëri të diskutueshme.</p> <p>2. Rritja e distancës etnike midis dy bashkësive kryesore: Ligji u përball me rezistencë dhe u pa si një sulm ndaj gjuhës maqedonase dhe pozitës së saj.</p> <p>3. Sfidat e zbatimit: Ligji duhet të zbatohet edhe në vendet ku nuk jetojnë shqiptarë gjë që, me gjasë, do të dëshmohej si një detyrë e vështirë, duke përfshirë si arsye edhe burimet njerëzore.</p> <p>4. Rritja e shpenzimeve publike: Ligji rrit përdorimin e gjuhës shqipe në një shkallë të tillë që, në mënyrë të pashmangshme, nënkupton se duhet të ndahen më shumë fonde nga buxheti publik me qëllim që të mbulohen shpenzimet e zbatimit.</p>



 EPI.Skopje

 epi_mk

 www.epi.org.mk